


BLEJ SHTËPI, BLEJ BANESË



BLEJ SHTËPI, BLEJ BANESË

Projekti "Blej shtëpi, blej banesë" në Maqedoninë e Veriut ka filluar në vitin 2012.

Qëllimi i projektit ishte të ofroj ndihmë financiare për blerjen e shtëpive dhe banesave për çiftet e reja, me qëllim të rritjes së nivelit të pronësisë dhe investimeve në sektorin e ndërtimit.

Mënyra e vetme e implementimit ishte përmes ofrimit të **subvencioneve** dhe **ndihmave financiare**.

Këto subvencione ishin të kushtëzuara me kritere të caktuara ku shuma totale për individ që ka blerë banesë apo shtëpi ishte prej **20.000** deri në **50.000** euro, të aprovuara si kredi banesore nga ana e bankave me afat të shlyerjes deri në 11 vjet.

KRITERET PËR APLIKIM PËR SUBVENCIONE

1

Personat që kanë qenë të martuar. Ata nuk duhen të kenë patur banesë ose shtëpi në emrin e tyre ose në emër të çiftit bashkëshortor, si dhe të hyrat mujore duhet të ishin deri në 1.300 euro

2

Personat që nuk kanë qenë të martuar. Ata nuk duhen të kenë patur banesë ose shtëpi në emrin e tyre, si dhe të hyrat mujore duhet të ishin deri në 900 euro.

3

Çmimi i shitjes së ndërtesës së banimit, banesë apo shtëpi, duhej të ishte deri në 900 euro për metër katror.

4

Sipërfaqja e banimit nuk duhet të tejkalonte 150 m².

NUMRI I SHFRYTËZUESVE TË PROJEKTIT “BLEJ SHTËPI, BLEJ BANESË”

VITI	NR. I SHFRYTËZUESVE
2012	104
2013	111
2014	196
2015	330
2016	326
2017	105
2018	106
2019	220
2020	228
2021	269
2022	53
TOTALI	2 048

Gjatë periudhës së zbatimit të projektit “Blej shtëpi, blej banesë” (2012–2022), ishin miratuar **2,048** kërkesa për kredi të subvencionuara për banim.


Numri i kërkesave të miratuara dallon prej vitit në vit, ku në vitin 2012 ka pasur vetëm 104 kërkesa të miratuara, kurse në vitin 2022, kishte një rënie drastike të kërkesave të miratuara në 53 kërkesa.

SHUMA E SUBVENCIONEVE TË DHËNA NË EURO

Që nga fillimi i zbatimit të projektit, shuma e kredive të miratuara nga bankat komerciale ishte më shumë se **75 milionë** euro, kurse subvencionet e miratuara nga shteti ishin mbi **18 milionë** euro. Në tabelën në vijim mund të shihni shumën totale e miratuar nga ana e shtetit prej vitit 2012 deri në vitin 2022.

VITI	SHUMA NË EURO
2012	610,000
2013	689,000
2014	1,298,000
2015	2,181,000
2016	3,801,000
2017	1,636,000
2018	1,527,000
2019	1,928,000
2020	1,949,000
2021	2,357,000
2022	505,000
TOTALI	18,481,000

KOMUNAT E QYTETIT TË SHKUPIT ME NUMËR MË TË LARTË TË SHFRYTËZUESVE



42.1% janë në komunat e Qytetit të Shkupit


KOMUNAT ME NUMËR MË TË LARTË TË SHFRYTËZUESVE JASHTË QYTETIT TË SHKUPIT

STRUMICË	167	KËRÇOVË	25
MANASTIR	140	PRILEP	24
KUMANOVË	65	SOPISHTE	22
GJEVGJELI	53	KAVADARC	16
SHTIP	52	RADOVISH	12
ILINDEN	51	DELLÇEVË	11
KOÇAN	49		
OHËR	43		
STRUGË	37		
VELES	32		
TOTALI	799		

KOMUNAT ME NUMËR MË TË VOGËL TË SHFRYTËZUESVE

KOMUNAT			
GOSTIVAR	9	MAKEDONSKI BROD	2
TETOVË	9	PETROVEC	2
SHËN NIKOLLA	8	BOSILLOVË	1
DIBËR	7	VASILLEVË	1
ÇUÇER SANDEVË	7	DEMIR HISAR	1
PROBISHTIP	5	ZHELINË	1
NEGOTINË	4	ZELENIKOVË	1
BEROVË	2	KRIVA PALLANKË	1
BOGDANCI	2	M. KAMENICA	1
VALANDOVË	2	SARAJ	1
TOTALI	67		

KOMUNAT SHQIPTARE ME NUMËR MË TË MADH TË SHFRYTËZUESVE



Projekti “Blej shtëpi, blej banesë” në përgjithësi ka rezultuar si projekt i suksesshëm duke marrë parasysh numrin e aplikimeve të pranura nga viti 2012 deri në vitin 2022. Në këtë periudhë, janë miratuar në total **2,048** kërkesa për kredi të subvencionuara për banim. Shuma e subvencioneve të dhëna nga ana e shtetit për projektin ishte **18.5** milionë euro.